



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.07.2016** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi **Nahit Elshani**, kryesues i Kuvendit, i cili ka konstatuar se ekziston forumi i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme. Prej 31 këshilltarëve vetëm një ka munguar.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e komunës z. Idriz Vehapi, Nënkryetarin e Komunës z. Xhemali Haxhimustafa, drejtorët e drejtorive, monitoruesin e KDI-së, KFORIT, OSBE-së, S.H.L – Kosova, mediat, këshilltarët dhe gjithë të pranishmit tjerë. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar,
2. Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët komunal,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për zgjerimin e zonës ndërtimore në Rahovec,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për subvencionimin e festivalit Hardh – Fest në Rahovec,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit Vendimit për zëvendësimin e një anëtarit të ri të komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale me anëtar të ri,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës të Kuvendit për vitin 2017,

Kryesuesi – E qes në aprovim rendin e ditës me këto 3 pika shtesë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar.

Në postën elektronike nuk ka pasur vërejtje sa i përket procesverbalit, a ka dikush tani të shtoj diçka.

Rukije Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, lidhur me diskutimin time që ka qenë në lidhje me zëvendësimin e anëtarit të KPF-së sipas kuotës, nuk është futë fare në Procesverbal. Unë jam që përfaqësimi i kuotës me qenë i barabartë sikurse në ekzekutiv, Kuvend dhe çdo ku tjetër.

Kryesuesi – E qes në aprovim procesverbalin me vërejtjen e dhënë nga ana e këshilltares: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverballi. Kalojmë në pikën e radhës,

2. Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët komunal.

Admir Oruçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishëm, do i përgjigjem pyetjes që e ka bërë Kuvendari Bahtjar Hoti: I nderuari z. Bahtjar. inspektorët komunal kanë dalë në teren dhe kanë konstatuar se me të vërtetë ka pasur prishje të shtratit Babovc. Ne si drejtori e kemi informuar Drejtorin e Shërbimeve Publike me gjendjen të cilën është ky shtrat dhe kemi kërkuar që të bëhet sanimi i kanalizimit. Pyetja e parashtruar nga Kuvendari Kadri Dellova: I nderuar Dellova sa jam unë i informuar nga inspektorët komunal kjo situatë ka ndodhur ma herët dhe kohët e fundit inspektorët nuk kanë hasur në kësi dukuri, por ne i kemi marrë të gjitha masat ndaj kompanisë së Radoniqit, e kemi detyruar Radoniqin që të pajiset me leje adekuate nga Drejtoria e shërbimeve publike. Pyetja e parashtruar nga Kuvendari Sinan Bajraktari. I nderuari Sinan Bajraktari po ju informoj se rruga Kromovik – Ratkoc disa herë janë inspektuar nga inspektorët e komunës dhe kanë hasur shumë herë në prerje të rrugës dhe trotuareve. Dëmtimet në fshatin Kramovik janë bërë nga Kompania e Radoniqit dhe disa qytetarë, inspektorët komunalë kanë ndërmarrë të gjitha masat ndaj K.R.U Radoniqit dhe qytetarëve të pa përgjegjshëm dhe për këtë raste janë bërë fletëparaqitjet për gjykatë. Përgjigjja e fundit është për Kuvendarin

Hysni Gashin, i nderuar ne kemi bërë njoftimin publik nëpërmjet mediave për të gjithë qytetarët e subjekteve të komunës për mos hedhjen e mbeturinave në lumenj, duke ju kujtuar s odë ndeshem me gjoba materiale konform udhëzimit administrativ dhe ligjit për mbeturina të MMPH, inspektorët komunal kanë dalë në teren ku kanë konstatuar se në disa segmente të lumenjve ka hedhje të mbeturinave, ne për këto raste e kemi informuar Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe tash mbetet tek ata që të ndërmarrin masa.

Kadri Dellova – Përsëndetje për të gjithë të pranishëm, e njoftoj drejtorin e inspektoratit se pas ndërhyrjeve të masave nga ana e kësaj drejtorie kjo punë është kryer me shumë sukses, prandaj e falënderoj drejtorin në emër të fshatit Krushë e Madhe.

Muhamet Behra – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, Pyetja e parë është parashtruar nga Kuvendari Fatmir Iska në lidhje me Riparimin e disa gropave në rrugët e Rahovecit: Ne menjëherë pas mbledhjes së kaluar kemi filluar që ti riparojmë disa gropat që janë shfaqur në rrugët e qytetit të Rahovecit, ndërsa ju njoftojmë se që nga sot kemi filluar që ti sanojmë ose riparojmë të gjitha gropat që janë në rrugën Kryesore Xhelala Hajda. Pyetja e dytë është nga Kuvendari Kadri Dellova lidhur me riparimin e kanalizimit të rrugës Janina në Krushe të Madhe. Ne si drejtori e kemi bërë riparimin e gypit të këtij kanalizimi, tani ka mbetur që vetëm rruga të kthehet në gjendjen se si ka qenë më parë. Pyetja e tretë është nga Kuvendari Besnik Hoti në lidhje me riparimin e rrjetit të ndriçimit publik në fshatin Ratkoc. I nderuar Besnik Ndriçimi publik është rregulluar në fshatin Ratkoc. Pyetja e katërt ka qenë nga Kuvendari Afrim Limani në lidhje me projektin për zgjerimin e ujit të pijes për fshatrat Guri i Kuq dhe Polluzhë. I nderuar Afrim tenderin për këtë pjesë e kemi shpallur dhe do të përfundoj me 27 pastaj do të vazhdohet me procedurat e më tutjeshme. Pyetje e pestë ka qenë nga Kuvendari Xhafer Bytyqi në lidhje me kanalizimet. I nderuar Drejtoria e Shërbimeve Publike ka pranuar të gjitha kërkesat nga Kryetarët e fshatrave sa i përket problemeve të kanalizimit, inxhinierët tanë janë duke i analizuar kërkesat ku besojmë se brenda muajit do të kompletojmë një para llogari dhe një para masë në mënyrë që të vazhdohet me një tender për zgjidhjen e kanalizimit në Komunën e Rahovecit.

Vjollca Vuçitërna – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, Pyetja e parashtruar nga Kuvendarja Rukije Krasniqi sa i përket presionit të bërë nga prindërit e nxënësve tek mësimdhënësit për përmasimin e notave, ne si drejtori komunale e arsimit nuk kemi marrë asnjë ankesë me shkrim as nga drejtorët e shkollave por as nga mësimdhënësit për ndonjë rast konkretë për presion nga ana e prindërve tek mësimdhënësit për përmisim të notave. Megjithatë vlerësimi i nxënësve nga ana e mësimdhënësve duhet të jetë korrektë dhe i vazhdueshëm gjatë vitit shkollor në përputhje me legjislacionin që është në fuqi dhe sipas udhëzimit administrativ nr.17/2013. Sa i përket vizitave të prindërve nëpër shkolla gjithashtu edhe kjo çështje është e rregulluar me normativ të veçanta, prindërit e kanë obligim ligjorë të i përgjigjen çdo ftese të kujdestarit ose menaxhmentit të shkollës sipas nevojës ose kërkesës së tyre, gjithashtu edhe vizitat e paralajmëruar nga ana e prindërve janë të mirëseardhura kur kanë të bëjmë me ngritjen e bashkëpunimit në trekëndëshin Prind, mësimdhënës dhe nxënës. Për drejtorin e arsimit është e papranueshme çdo lloj spekulimi dhe çdo lloj presioni nga secila palë, në rastet të paraqitjes së ndonjë rasti të kësaj natyre DKA-ja do të veproj në bazë të legjislacionit që është në fuqi. Pyetja e dytë është bërë nga Kuvendari Sinan Bajraktari në lidhje se deri kur do të jetë në listë të pagave ish drejtoresha e shkollës Milaim Krasniqi në Pastasel. Drejtoria Komunale e Arsimit duke u bazuar në udhëzimin administrativ 08/2014 të datës 25.02.2014 të MASH-it dhe rekomandimin e Ministrisë së Arsimit nr. 317 2695 të dt. 08.06.2016, drejtoresha Bubulina Berisha në listë të pagave do të mbetet si mësuese mbështetëse deri më 31. Gushtë 2016, deri sa të bëhet një sistemim adekuat edhe për të.

Kryesuesi – Drejtorët më nuk kanë përgjigjur nga pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar, a ka dikush tani të bëjë ndonjë pyetje për drejtorët komunal.

Fatmir Iska – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, kam dy pyetje, pyetja e parë ka të bëjë me muajin e mërgimtarëve, a ka bërë ndonjë plan komuna e Rahovecit për pritjen e mërgimtarëve. Pyetja e dytë ka të bëjë me dëmet e fundit që i ka bërë breshëri në bujqësi, sa e di unë është formuar një komision për vlerësimin e dëmeve, kërkoj nga Kryetari i komunës që të bëjë ma tepër presion në Ministrinë e Bujqësisë, që të bëjë pagesa edhe për këto dëme të shkaktuara.

Rukije Krasniqi – Dua ta di a ka ndonjë ndihmë nga ana e Komunës për personat e vetmuar përveç pasioneve të cilët i marrin, unë nuk e di se si ja dalin ata me këtë pension të i paguajnë obligimet komunale e mos të flasim për gjërat tjera elementare.

Kadri Dellova – Kam një pyetje për Drejtorin e Administratës, a ka Komuna e Rahovecit ndonjë interpretues për persona të veçanta pra për shurdh memecë.

Sinan Bajraktari – Përsëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime shkon për drejtorin e arsimit, studentët që janë duke e kryer fakultetin e Edukatës Qytetare, këtë studentë asnjë vite nuk po mundën të gjejnë vend për të u punësuar, për shkak të orëve të pakta, ky problem është duke na përcjellë që 10 – 15 vite. Shkollat të cilët i kanë nga 4 – 5 orë edukatë qytetare asnjëherë nuk janë duke i shpallur si të lira vendet e punës dhe këto orë janë duke i mbajtur profesorët e gjeografisë dhe Historisë. Dua ta di a ka ndonjë udhëzim administrativ që e

rregullon këtë problematik, këta studentë që diplomojnë në lëndën e Edukatës Qytetare a do të mbesin gjithmonë pa punë apo si do të bëhet me ta.

Besnik Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha ta ngris një shqetësim timin dhe të qytetarëve në Drejtorin e Inspektoratit, Disa qytetarë janë duke e ujtur asfaltin me ujë, ata në mënyrë të pa vetëdijshtë po e rrezikojnë komunikacionin ku në pjesën ku jetoj unë ka pas disa aksidente, dua ta di a ka mundësi Drejtoria e inspektoratit që të ndërmerr diçka në lidhje me këtë problematik.

Kryesuesi - A do të përgjigjet ndonjë drejtorë sot pyetjeve të parashtruara.

Sali Sallteku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, Kadri Dellova pyeti a ka komuna jonë të punësuar ndonjë zyrtarë ose interpretues për personat të veçantë, ne si komunë nuk kemi të punësuar një zyrtar të tillë, ne kemi pas raste të palëve me nevoja të veçanta por ata zakonisht vinë me përcjellësit e vetë dhe deri më tani nuk kemi pas asnjë problem. Sa i përket pyetjes që e bëri Fatmir Iska për Muajin e Mërgimtarëve, është nxjerrë një vendim nga zyra e Kryetarit ku orari i punës së disa punëtorëve të administratës është zgjatur deri në ora 18:00, të shtunën gjithashtu prej orës 9:00 – 12:00, gjithashtu i kemi shtuar edhe dy sportele për mërgimtarët me kërkesë të Ministrisë së Diasporës.

Admir Oruçi – I nderuar Kuvendar Besnik Hoti, ne javën e kaluar kemi marrë një shkresë nga kompania e Radoniqit në lidhje me problemin e ujit që është duke u derdhur në asfalt, ne si drejtori i kemi angazhuar Inspektorin e për çështje komunale, ne një herë këtyre qytetarëve ju kemi dhënë vërejtje në mënyrë që mos të shkojmë menjëherë me fletëparaqitje për gjykatë por nëse përsëritet prapë kjo dukuri ne do të jemi të detyruar që të shkojmë me fletëparaqitje për gjykatë.

Kryetari – Përgjigje për Fatmirin: për dëmet e shkaktuara nga Breshëri, ne si komunë e kemi formuar komisionin, ata kanë dalë në teren, kanë bërë verifikimet e dëmeve, dëmet janë të mëdha milionëshe. Këto të dhëna i kemi proceduar në Ministrinë e Bujqësisë ku presim përgjigje nga ana e tyre. Të gjithë e dini se Kosova nuk ka fond të veçantë, nuk ka kompani të sigurimeve, nuk ka fonde për rimbursim të hyrave për dëme, pastaj nuk ka pagesa nga ana e qytetarëve për sigurimin e produkteve bujqësore. Nëse ka ndonjë të ardhur ose kompensim për dëmet e shkaktuara do të ishte e mirëseardhur për bujqit e komunës sonë, por siç e ceka më lartë është shumë problem që këto dëme të kompensohen. Është e vërtet se duhet të bëhet trusni në nivel vendi që sa ma shpejtë ta ketë fondin për këto raste të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, por ne duhet të presim se çka do të ndodhë të ardhmen sepse këto vendime nuk mundet me i marrë as niveli komunal por as niveli ministror, këto janë vendime të cilat dalin nga kabineti qeveritar pra nga Kryeministri i vendit. Sa i përket diasporës ne tradicionalisht e kemi një ditë për pritje, kemi bërë një ftesë publike, ku nuk ka pas shumë të interesuar për të ardhë ata të cilët kanë ardhur unë i kam pritë në zyrën time. Po ashtu sa e di edhe Drejtori i Kulturës e ka organizuar një turnirë për këto ditë të diasporës, diçka të veçantë nuk kemi pas për shkak të mungesës së fondeve, e di së është mirë që këtyre njerëzve të i bëjmë një trajtim pak më dinitor sepse të gjithë e dimë kontributin e tyre që kanë dhënë për Kosovën si të kaluarën, si tani besojmë se do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, pra kjo është situata. Për pyetjen që e bërë Rukija kam shumë respekt për pensionistët tanë dhe për këtë shqetësim të Rukijes por komuna jonë nuk ka fond për gjëra të tilla, kjo duhet të rregullohet në nivel vendi për lirimet komunale dhe gjërat tjera për ta ne edhe përkundër që kemi dëshirë me i ndihmuar tani për tani nuk po kemi mundësi.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015.

Kryetari – Raporti i auditorit që na është dërguar si version i fundit, dua ta them se e kemi pranuar si një raporte real me të gjitha ato të gjetura i ngërthen në vete dhe rekomandimet duhet të i adresojmë. Opinioni i auditimit është në pikën 1.2 duhet të sqarohet në detaje se si është gjendja në komunën tonë, do e lexojë vetëm atë që është e rëndësishme. Pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave si dhe buxhetit të realizuar të komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar 31.12.2015 në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publikë, të kontabilitetit për para të gatshme ligji nr. 03/ L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë me plotësime dhe ndryshime dhe rregullën financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/ 2013 për pasqyrat vjetore financiare për organizatat buxhetore. Raporti është i pamodifikuar dhe me theksim të çështjeve janë të regjistruara ato, më së shumti më befason fakti se ne e kemi një zyrtarë për regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe për fat të keq asnjë vite nuk është ky regjistër i plotë dhe për mendimin tim është një punë që mundet të kryhet për një javë.

Selim Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Ky raport i auditorit ka adresuar diku 14 çështje, 11 janë me prioritet të lartë dhe 3 me prioritet të mesëm. Nëse e analizojmë mirë këtë raport do të shohim se nuk ka ndryshime nga raporti i vitit të kaluar. Do të ndalem tek shkeljet që janë bërë në këtë raporte, këto shkelje janë bërë kryesisht tek ekzekutimi i buxhetit, tek zyra e prokurimit, tek menaxhimi, zyra e auditimit etj. Gjithashtu rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë marrë për bazë shumë dhe janë lënë anësh, p.sh keq klasifikimi i shpenzimeve janë përsëritur edhe në këtë vite ku nga investimet kapitale janë paguar mallrat dhe shërbimet.

Afrim Limani – Auditimi i pasqyrave financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2015 ka një dallim të madh në krahasim me vitin 2014. Në përmbajtje raporti është i vlerësuar pozitivisht, por përkundrazi edhe ky raporte ka disa mangësi të mëdha, ajo që për mua është ma e rëndësishme për me cekë është se ky raporte ka shumë pak mostra të ekzaminuara dhe të them të drejtën edhe për këtë raporte unë po paragjykoj që auditorët kanë qenë të ndikuar, pse e them këtë do e shohim ma vonë gjatë diskutimit të raportit. Ajo që është ma karakteristike në komunën e Rahovecit që nga pas lufta e deri më tani është mos regjistrimi i pasurive komunale. deri në vitin 2011 në pasqyrat financiare gjendja e pasurive ka qenë zero, por në momentin që kemi ardh ne në pushtet kemi lëvizur diçka në të mirë mirëpo tani prapë na përsëritet i njëjti problem i cili mundet të eliminohet siç e tha edhe vet Kryetari për një javë, por vetëm duhet të jetë gatishmëria e menaxhmentit, pra ku janë defektet dhe pse kemi probleme tek regjistrimi i pasurisë, mos ka mungesë të profesionalizmit apo diçka tjetër është në pyetje. Auditori pikërisht për këtë e ka cekë një fjalim që mua personalisht më ka lënë shumë përshtypje, në faqe 5 thuhet: sistemi i kontrollit të brendshëm në aspektin e raportimeve në nivelin e tanishëm nuk ofron sigurinë se aktivitetet operative dhe financiare të komunës kryhen në mënyrë efektive, dhe si tëllë, ka nevojë të ketë një mbikëqyrje të shtuar dhe përmisim në disa fusha, pra mungesa e kontrollit nga ana e menaxhmentit i ka krijuar të gjitha këto defekte që i ka paraqit raporti i auditorit. Do i lexojë disa pika që konsideroj që ja velen të diskutohet. Auditori i ka gjetur 3 të gjetura kryesore e ato janë mos regjistrimi i pasurive, pastaj pagesa e mallrave nga kapitalet në mallra dhe shërbime, këtë të fundit unë e arsyetoj sepse ne jemi detyruar që të paguajmë patjetër Caritasin, mirëpo nëse ish bërë planifikimi ma i mirë i buxhetit ndoshta do të kishim mundur që mallrat dhe shërbimet me i reduktuar në nivel më të vogël, pastaj e gjetura e tretë është mos regjistrimi i donacioneve në sistemin SMFK dhe mendoj se kjo është një papërgjegjësi. Nga rekomandimet e vitit paraprak që kanë qenë 16 vetëm 4 janë adresuar dhe implementuar, 5 tjera vetëm janë adresuar por nuk janë implementuar ndërsa 7 të tjera as nuk janë adresuar por as nuk janë implementuar. Në faqen 15 të raportit janë të cekura dobësitë në kontrollet menaxheriale si prioritet i lartë. Në faqe 16 janë të cekura dobësitë e punës së auditimit të brendshëm dhe komitetit të auditimit edhe kjo si prioritet i lartë, pra kjo është një sfidë dhe problem që është duke u paraqitur tek auditorët si e gjetur nga ana e auditorëve të jashtëm, mendoj se është e gjetur me vende sepse ne jemi në vitin fiskal 2016 ndërsa auditori i brendshëm ende nuk na ka ofruar raportin e vitit 2014, propozoj që auditimin e vitit 2015 fare mos me e bë në mënyrë që të ecim me kohë dhe le të mirët me auditimin e vitit 2016. Komuna këtu e cek se e ka të themeluar komitetin e auditimit që nga viti 2014 por nuk ka qen funksional asnjëherë, pyetja ime është pse, në mandatin e kaluar ne e kemi formuar komitetin e auditimit, sa e di unë në vitin 2013 është mbajtur vetëm një mbledhje dhe po nga ky kuvend ne kemi marrë koça kritika të mëdha. Kur e thash në fillim se po paragjykoj se auditorët kanë qenë të ndikuar pe ndërlidhi me faktin sepse tek realizimi i buxhetit thotë: Buxheti për kategorinë investimeve kapitale ishte shpenzuar në një nivel më të ulët se në kategoritë tjera 87%, kjo kishte ndodhur për shkak se disa kontrata ishin lidhur në funde të vitit 2015. Po ashtu, në ekzekutim të ulët kishte ndikuar edhe dështimi i ekzekutimit të disa kontratave për shkak se punimet nuk ishin kryer sipas specifikave të kontratës dhe komisionet e pranimeve teknike nuk kishin pranuar punimet e ekzekutuara, po nuk e di se pse auditori nuk e ka cekë edhe shumën se sa ka qenë ajo vlerë e suficitit. Tjetër si dobësi është planifikimi i dobët i prokurimit respektivisht lidhja e kontratave në funde të vitit e cila e ulë aktivitetin e komunës në realizimin e projekteve kapitale dhe shfaqet suficiti. Në raportet e kaluara kam thanë që është e pakuptimtë që kontratat të lidhen në funde të vitit. Në fund tek prokurimi thotë dobësitë sistematike në prokurim. Fokusi imë është tek një projekte e ai është ndërtimi i rrugëve lokale në Rahovec, auditori ka konstatuar se kjo kontratë ka qenë e lidhur n vitin 2013, ndërsa në vitin 2014 menaxheri i këtij projekti e ka ndryshuar projektin dhe kontratën ku i ka destinuar për tu kryer disa rrugë tjera, mendoj se kjo është një shkelje ligjore dhe menaxheri i projektit duhet të jepe një përgjegjësi. Tek kontrata për shërbime të veçanta auditori ka gjete se janë paguar 43,000.00 € nga mallrat dhe shërbimet punëtorëve që kanë qenë me kontratë mbi vepër. Në faqe 4 të raportit thuhet se Kryetari i komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjen dhe konkluzionet e auditimit në këtë raporte, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna. Ne

konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari do ta sqaroj raportin e auditimit në Asamblenë komunale dhe deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutoj në Asamblen Komunale progresin lidhur me implementimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVP e vitit 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave. Kryetar propozoj që këtyre pikave riji gati, i kam propozuar edhe kryesuesit sepse edhe auditori e ka cekë se gjithsesi në muajin janar duhet të jenë si pikë e veçantë e rendit të ditës edhe rekomandimet në asamblenë komunale.

Kryetari – Afrim faleminderit shumë, unë me përgjegjësi të plotë e them se paragjykimet e juaja mundem të i mbajë por auditori ka qenë i lirë me i kërku të gjitha mostrat çka atyre ju ka interesuar, dhe kurdo që dëgjoni që ka pas ndikime ju kisha lutë që të filloni nga Kryetari dhe dërgoni dyshimet e juaja aty ku duhet.

Flori Boshnjaku – Raportin që e kemi nga auditori i përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2015 nuk duhet të mburremi as ne, as Kryetari i komunës, as Kryesuesi, as Drejtorët dhe aq më pak Drejtori për Financa, nëse një punë ka mundur të kryhet për një javë atëherë pse nuk është kryer. Ky raporte ka qenë në KPF ku ne e kemi shqyrtuar dhe i kemi lënë vërejtjet tona. Ish drejtori i shërbimeve publike është deklaruar se ne nuk jemi pajtuar me këto rekomandime, ndërsa në raporte shkruan se kryetari i Komunës është pajtuar me këto të gjetura dhe këto rekomandime, unë i kam thanë a komunikoni ju me Kryetarin apo jo nëse nuk jeni pajtuar atëherë është dashur të shkruhet se nuk jeni pajtuar.

Kryetari - Florije Përgjegjësitë janë individuale unë jam pajtuar ndërsa ata që nuk janë pajtuar nuk kam çka ti bëjë nuk janë pajtuat dhe le të argumentojnë.

Flori Boshnjaku – Mirë e the Kryetar se përgjegjësitë janë individuale, mirëpo nëse ti je pajtuar me këto të gjetura drejtori është dashur të sjellë ty argumente dhe arsye se nuk janë të vërteta këto çka janë në raportin e auditorit të përgjithshëm. Në lidhje me të gjeturat që i ka gjetur auditori në faqe nr.4 që nuk është regjistruar vlera dihet, po ashtu edhe 120 hektar tokë komunale nuk janë regjistruar, pastaj edhe lokalet që janë pronë e komunës nuk janë regjistruar. Është bërë keq klasifikimi për afërsisht është fjala për investimet kapitale ku gati 400,000.00 € dhe në një vend tjetër plus 100,000.00 € kanë shkuar në suficit, pra janë marrë 500,000.00 € nga investimet kapitale, në raporte këto vlera nuk janë cekur. Për subvencione thuhet se janë paguar 40,000.00 €.

Kryetari – Sipas auditorit të jashtëm Keq klasifikimi është nga investimet kapitale që i kemi qitë në mallra dhe shërbime, tek pagesat që i kemi bërë për Caritasin. Sa i përket subvencioneve a e dini pse është bërë sepse vetëm 123,000.00 € janë në vitin që jemi ndërsa ministria e financave kur i dërgon se sa kemi të drejtë ne nuk mundemi me i kalu ato vija, prandaj ne jemi të detyruar që nga investimet kapitale me i bë disa pagesa në subvencione, pra kjo është keq klasifikimi që e kanë gjet auditorët, por kryesorja e kësaj është se nuk është keqpërdorim. Për këtë unë pajtohem me të gjitha të gjeturat që i ka cek auditori i përgjithshëm.

Flori Boshnjaku – Në faqe nr. 9 ku thuhet rreziku i regjistrimit të pasurisë ku thuhet se komuna kishte mbivlerësuar investimet në vlerën prej 58,920.00 € duke regjistruar dy herë pagesat e të njëjtit projekt. Ish drejtori i shërbimeve Komunale z. Fetoshi ka deklaruar se ne i kemi rregulluar rrugët në komunën e Rahovecit.

Kryetari – Do ju përgjigjem në emër të z. Fetoshi aq sa kam unë informacion, këtu bëhet fjalë për rrugën Mustaf Ibishi, pastaj disa rrugë në Krushe të Madhe dhe një rrugë në Drenoc që janë investuar nga Ministria e Infrastrukturës, këto pastaj janë plotësuar në hapësirat e tjera ku i kemi pas në komunën e Rahovecit, pra këtu kanë ndodhur ndryshimet, pra këtu asgjë nuk ka të keqe.

Flori Boshnjaku – Në faqe nr. 12 thuhet: Komuna ka hyrë në obligim ma shumë se sa është ndarja buxhetore për vitin 2015/2017 për 3 projekte. Tek auditimi i brendshëm është mirë të bëhet auditimi për vitin ekzistues e jo për vitin e kaluar sepse kur na vije raporti i auditorit të jashtëm nuk ka kurrfarë rëndësie raporti i auditorit të brendshëm.

Kryetari – Askush nuk i ndalë auditorët që të bëjnë aludimin, ne kemi kërkuar disa herë nga ta që të kryejnë auditimin në disa vende pa i paralajmëruar, por tash sa e din ata unë nuk e di aty, ata duhet të përgjigjen për punën e vetë të cilën e kryejnë.

Kryesuesi – Qëllimi i auditorit të brendshëm është që ta paralajmëroj Kryetarin e komunës për rreziqet që i ka komuna ose ndonjë drejtori e caktuar, e jo me i konstatu të gjeturat e vitit të kaluar sepse nuk ka efekte.

Asllan Mazreku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para se ta marrë pozitën e menaxherit të asetëve komunale nga mesi i vitit 2013, pasuritë komunale të komunës së Rahovecit kanë qenë jashtëzakonisht keq dhe raporti i auditimit në atë kohë është përmbledhë me një resht. Pasuritë mbi 1000 € deri në mesin e vitit 2013 nuk kanë qenë të evidentuara, me ardhjen time në pozitën e menaxherit të asetëve komunale kemi një përmisim bukur të mirë të menaxhimit dhe regjistrimit të pasurive komunale. ndërsa pasuritë më pak se 1000 € kanë qenë

pjesërisht të regjistruara. Kurse raporti i regjistrimit të pasurive që është bërë në funde të vitit 2015 është 56,374,844.91 €. Mbi 1000 € i kemi të evidentuara të gjitha. Sa i përket raportit të auditorit ka gjetje që janë reale por ka edhe prej atyre që nuk janë reale, i kam cekë disa pika ku auditorët pretendojnë se i kanë bërë gjetje po ashtu i kamë shënuar komentet e mija lidhur me ato gjetje. P.sh thuhet se nuk janë regjistruar 120 hektar tokë, këtu ata kanë gabuar sepse nuk janë 120 hektar por janë 12,072.96 hektarë tokë, komisioni i ka vlerësuar 69,150.42 hektar, pra janë të paregjistruar nga ana e komisionit edhe 12,079.96 hektarë tokë. Pastaj ata e kanë cekur edhe mos regjistrimin e 8 lokaleve afariste, kryetari e ka formuar komisionin për vlerësim ata kanë dalë në teren, komisioni gjatë daljes në teren i ka regjistruar 18 lokale afariste, ndërsa 9 lokale nuk janë regjistruar sepse nuk kanë vlerë financiare. Rregullorja mua nuk më lejon me i futë në sistem një pasuri nëse nuk ka vlerë financiare, mendoj se këtu është mos përgjegjësia e komisioneve sepse ato formohen dhe nuk e kryejnë punën ashtu si duhet. Pastaj auditorët e kanë gjetur se dy vetura nuk janë të regjistruar në fri – balance, në këtë pikë auditorët kanë gabuar sepse ja ku e kam para juve raportin që komisioni i ka vlerësuar këto dy vetura që janë në përdorim, për këto dy vetura që aludojnë auditorët se janë jashtë përdorimit ato janë në përdorim dhe për ate komisioni i ka vlerësuar si vetura që janë në përdorim.

Avdullah Kryeziu – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, Mendoj se gjatë prezantimit të raportit dhe të komenteve zyrtari për asete e bëri një gabim sepse nuk janë 12 mijë hektar e as 69 mijë por janë 120 hektar, dhe nga këto 12 hektar kanë mbete pa regjistruar 12 hektar e 72 ari 69 m² ndërsa janë regjistruar 69 hektar e 150 ari e 42m². Një pjesë e madhe e kësaj pasurie është tjetërsuar të gjithë e dimë se si janë bërë. Mendoj se këto prona do të evidentohen nga zyrtarët që i janë punësuar nga komuna në bashkëpunim me Demosin dhe në funde besoj se do të kemi një raporte real të pasurisë komunale. sa i përket vërejtjeve të tjera i tha edhe zyrtari për asete, kështu që edhe unë si drejtor kam vërejtje për zyrtarin për asete sepse në shumë raste në raporte ka dalë se dy herë janë regjistruar pasuritë e njëjta dhe është ritë shuma e vlerësuar e pasurisë. Unë në këtë drejtori jam drejtor nga muaji shkurt 2014 ndërsa ky raporte që është dërguar tek auditori është i muajit shkurt të 2014 prandaj unë nuk mundem të japë kurrfarë komenti për komisionin që ka qenë në ata kohë.

Afrim Limani – Nuk pajtohem me të gjitha ato që i tha zyrtari për asete, pajtohem vetëm për një gjë me të se nëse ja kanë sjellë një aset pa e shprehur vlerën monetare është normale dhe pajtohem me atë që nuk guxon me e regjistrua. Por jam i sigurt se asnjë komision zyrtarit për regjistrimin e aseteve nuk i dërgon ndonjë dokument pa vlera monetare. Auditori thotë kështu: Komuna kishte adresuar rekomandimet për regjistrimet e pasurive por nuk kishte arritur ende që të krijoj një regjistër përfundimtar, në këtë kuptim komuna kishte mbivlerësuar investimet në vijim për 85,000.00 € duke i regjistruar dy herë pagesat e njëjta për projektet ndërtimi i rrugëve të Rahovecit dhe kanalizimin në fshatin Pastesël, si dhe kishte mbi vlerësuar investimet në vijim për 352,000.00 € për shkak se 16 pagesa për projektet e ndryshme ishin regjistruar si shpenzim në regjistrin kontabël por jo edhe si investime kapitale. Mendimi imë përfundimtar është se gjithmonë auditori është duke bërë rregullisht të gjetura, ne mundemi me e rregullu këtë punë vetëm duhet të përkushtohemi të gjithë, në rastin konkretë tani përgjegjësia mbetet tek menaxhmenti e kjo punë mundet të kryhet për një javë.

Qazim Qeska – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, Raportin e auditimit që e kemi pranë veti në formën versionin dhe përmbajtjen përfundimtare. Kryetari i Komunës si menaxhment kryesor i komunës në mënyrë shumë të qartë e ka cekur në momentin kur auditimin e ka pranuar, pra është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe i ka pranuar rekomandimet, gjithashtu është zotuar ashtu siç e parashohin aktet juridike në të cilët ai është mbështetur, prandaj konsideroj se Kryetari detyrën e parë e ka kryer. Ne këtu si përfaqësues të partive politike kemi të drejtë të i japim mendimet e subjektivit që e përfaqësojmë dhe të japim mendimet, qëndrimet dhe bindjet e veta personale. Por unë me bindje të plotë e them se ne këtu si asamble ose si përfaqësues të popullit e jo si përfaqësues të subjekteve politike, duhet në rrallë të parë ne duhet të falënderojmë punën e auditorit, i cili vetë ka thënë se administrata e komunës ka qenë korrekte, në radhë të dytë duhet falënderuar edhe kryetarin e komunës për korrektësi ngase i ka pranuar në përpikëri të gjeturat edhe rekomandimet e auditorit, po ashtu është zotuar që së bashku me bashkëpunëtorët e vetë do të mirët me eliminimin e rekomandimeve dhe të gjeturat si dhe do të mundohet që ti eliminoj me kohë. Sidoqoftë ne kemi të drejtë të kemi dyshime por nuk kam dëgjuar prej asnjë kolegu këtu që në mënyrë konkrete të argumentoj me fakte dhe me prova se cila e gjetur na auditori nuk është e saktë, ku qëndron ai ndikimi që ju është bërë auditorit, pra duhet të kesh fakte për këtë sepse auditori është organ i pavarur i cili punon sipas ligjeve në fuqi, por mbi të gjitha auditori edhe vet e cek në raporte që nuk ka pasur asnjë pengesë gjatë auditimit. Jemi lidhur mbi vlerësimin dhe regjistrimin e pasurisë që e ka gjetur auditori si të gjetur, ky fakt bartet prej ish kryetarit Esat

Haxhijahës, pastaj Smajlin dhe tash me Kryetarin aktual, por mendoj se në rrugë të mirë është Kryetari aktual që edhe këtë çështje ta adresoj ashtu siç e parashohin rekomandimet. Unë kam bindjen si këshilltar duhet falënderuar dhe pranuar punën e auditorit dhe korrektësinë e kryetarit së bashku me bashkëpunëtorët e vetë.

Hysni Gashi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, mendoj se të gjitha që u thanë deri më tani janë të përfshirë në raportin e auditorit, mendoj se auditori sa herë ta auditoj një institucion do të gjen diçka, pra nuk ka institucion që në mënyrë perfekte i kryen të gjitha obligimet. Ajo që mua më intereson që ky diskutim me rjedh më mirë është unë mendoj se auditimi është bërë ekskluzivisht për punën e ekzekutivit, prandaj mendoj se kishte me qen mirë që këtë raporte me e lexu drejtorët përkatës dhe me dhënë arsyetimet e veta për të gjeturat e pastaj të hapet debati. Or mbase ja kemi filluar kështu unë i kam dy raste për ti potencuar: mbase auditori i brendshëm e ka auditu drejtorin e financave dhe zyrën e prokurimit për vitin 2015, është dashur që raportin e vetë ta inkorporoj në auditimin e përgjithshëm. Tek zyra e prokurimit ka plot të gjetura, njëra prej tyre është që nuk bënë të jepet tenderi ma larg se 10 km operatorit për mirëmbajtje të automjeteve, pra këtu krijohen rrethanat lehtësuese për operatorët e caktuar, pastaj nuk janë bërë njoftimet me kohë për ata që janë eliminuar.

Kryesuesi – Drejtorët i kanë dhënë arsyetimet tek auditori, ata i kanë marrë parasysht ato që i kanë menduar ata se janë të arsyeshme dhe ato që nuk i kanë marrë besoj se nuk kanë pas arsye me i marrë. Qëllimi i debatit është se si me i elemnu në të ardhmen këto të gjetura.

Rukije Krasniqi – Në faqe 23 çështja nr.11 kontrata për shërbime të veçanta, prioritet të mesëm. Si e gjetur është se komuna gjatë vitit 2015 kishte të angazhuar 35 punonjës me kontrata për shërbime të veçanta, për këto shërbime pagesat janë bërë nga kodi mallrat dhe shërbime në shumën prej 43,404.00 €. Lidhja e kontratave me shërbime të veçanta më shumë se 6 muaj është në kundërshtim me ligjin e shërbimit civil. Rekomandim për Kryetarin është që duhet të rishikoj kontratat për shërbime të veçanta dhe të siguroj se kontratat e tilla të përdoren vetëm për nevoja reale. Pyetja ime shkon për Kryetarin: Meqenëse këta 35 punëtor janë në kundërshtim me ligjin, dua ta di çka do të bëjë kryetari me këta 35 punëtor, a do ti ndërprejnë kontratat. Shumica e këtyre punëtorëve janë familjar të këshilltarëve komunal, anëtar të militantëve të koalicionit qeverisës.

Kryetari – Rukije shumica e atyre kontratave kanë qenë 4 mujore, asnjë kontratë nuk ka qenë mbi 6 muaj për vite fiskal mendoj, këtë e them me përgjegjësi të plotë. Këtë vite i kemi disa punëtor vetëm për 4 muaj askujt nuk do ti vazhdohet për këtë vite sepse e respektoj ligjin.

Asllan Mazreku – Unë këtu para veti i kam disa dokumente që janë të vlerësuara nga komisioni dhe disa që janë të pa vlerësuara, gjithashtu tek regjistrimi dy herë i projekteve është gabimi imë e pranoj, por shikoni me dt.22.06.2015 e kam dërguar kërkesën për shlyerje në Ministri të Financave, pra ky problem nuk është tek unë e kam dërguar ata është dashur të shlyejnë.

Lulzim Sylejmani – Ju kisha lutë që raportet e auditorit dhe raportet financiare që ti lexoni drejtë ashtu siç janë të pasqyruara e jo të thuani se janë paguar dy herë. Pasqyrat që i ka pasqyruar auditori janë të drejta dhe Kryetari është pajtuar me to. Ne i kemi dërguar disa rekomandime, po ashtu edhe të ish drejtorit të shërbimeve publike por ata nuk e kanë marrë për bazë sepse kanë konstatuar që gjendja është kjo që është reale. Sa i përket projekt ekzekutimit të buxhetit, ne të gjithë e dimë që mbase realizimit të të hyrave vetanake qsa sa kanë qenë të planifikuara ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në mos realizimin e investimeve ,kapitale. Sa i përket grandit qeveritar tek investimet kapitale ju e keni pas raportin, pra vetëm 67,000.00 € kanë shkuar në suficit, tjerët kanë qenë të hyrat vetanake që na u kanë bartë. Një projekt që e ka specifiku auditori se pse nuk e kemi bërë pagesën për një rrugë, sepse nuk ju është pranuar puna nga komisionet komunale, kur e ka rregulluar rrugën është kryer pagesa, pra auditori ka konstatuar një gjendje reale. Auditori për dallim nga viti 2014 e ka dyfishuar marrjen e mostrave e kjo është shumë e mirë për ne. Tek çështja e aseteve, vetëm 4 komuna e kanë të kryer regjistrimin e aseteve, kjo nuk është punë që kryhet për një javë ose dy javë kjo kërkon angazhim goxha të madhe për me i evidentu gjendjen e tyre dhe regjistrimin. Sa i përket pasqyrave financiare auditori thotë se janë të pasqyruara drejtë, asnjë send nuk është shmangur. Mirëmbajtjen e rrugëve ata prapë kanë me qitë si klasifikim por ne duhet patjetër me i mirëmbajttë rrugët deri sa të rregullohet. Pra ky raporte është përshkrime i gjendjes reale.

Afrim Limani – Drejtor suficiti nuk ka qenë 65,000.00 € por ka qenë 150,000.00 €, këto po e them në bazë të raportit që e ke shkruar ti në pasqyrat financiare. E dyta që e the për regjistrimin e pasurive duan kohë dhe proces, është shumë e vërtet, por unë e thash dhe prapë qëndroj mbas asaj që thash kjo punë mundet të kryhet për një javë, pse e them se kryhet për një javë sepse ne jemi duke e parë problemin ku është, pra problemi është tek jo profesionalizmi. Sa i përket mostrave të ekzaminuara që e the ti janë marrë më shumë këtë vit, në krahasim me raportet e tjera nuk ka shumë mostra. Sa i përket keq klasifikimit të shpenzimeve unë e arsyetoj,

mirëpo munden të zvogëlohen vlerat, të paktën kur ta bëjmë planifikimin e buxhetit me i kursye disa kategori nga mallrat dhe shërbimet.

Kryesuesi – Është mirë që plani i veprimit i implementimit të rekomandimeve të kryetarit që janë të obliguar brenda një muaji me ja dërgua auditorit të jashtëm, kishte me qen mirë që në janar të vitit 2017 me qen si pikë e veçantë e rendit të ditës për kuvend në mënyrë që të shohim se sa janë implementuar rekomandimet e auditorit. Ju falënderoj gjithashtu për diskutimin e bërë në lidhje me raportin e auditorit. kalojmë pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për zgjerimin e zonës ndërtimore në Rahovec.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pas punimeve të rrugës transite nën bjeshkën e Rahovecit në Drejtori për Urbanizëm kemi pranuar disa kërkesa nga qytetarët për përcaktimin e pjesës dhe ngastrave kadastrale se çka janë të paraparë me planin zhvillimor komunale. Kjo zonë është pronë komunale është diku 119 hektar e ndarë në 6 parcela e që menaxhohet nga agjensioni pyjor i Kosovës. Një kërkesë kemi pas nga një ri për ndërtimin e fermës së dhive, tjetër kërkesë kemi pas për mbledhjen e mjedrave. Ne të gjithë e dimë se atje nuk ka ujë dhe nuk munden të mbjellën mjedrat por kanë qëllime të caktuara. Por ne si drejtori duhet të i përgjigjemi kërkesave të qytetarëve, prandaj ne ve na ka lindë si ide dhe ja kemi paraqitur Kryetarit, kryetari i ka propozuar KPF-së për zgjerimin e zonës ndërtimore në atë pjesë rreth rrugës me të vetmin qëllim që ajo zonë ta ketë një destinim të caktuar me dokumente valide në të ardhmen për planifikimin hapësinor. KPF-ja e ka proceduar në Kuvend, prandaj unë ju propozoj juve që të merrni iniciimin e procedurës për zgjerimin e zonës ndërtimore rreth rrugës transite në Rahovec. Pasi të mirët ky vendim do të zhvillohen të gjitha procedurat ligjore duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, statutit të Komunës dhe ligjit për planifikimin hapësinor ku do të mbahen edhe debatet publike. Po ju paralajmëroj se edhe në të ardhmen do të kemi iniciativa të tjera për zgjerimin e zonave ndërtimore edhe nëpër fshatra. Ju ftoj që ta mbështetni këtë iniciativë dhe neve të na hapni rrugë që të punojmë në të ardhmen.

Florije Boshnjaku – Si iniciativë është shumë e mirë, kishte me qenë mirë që edhe në fshatrat ku do të jenë zona ndërtimore një herë për gjithmonë të japin mendimin dhe të fillohet të punohet në këtë aspekt. Drejtor po të pyes mos jemi duke bërë ndonjë shkelje kur ende ligji për pylltari në Kuvendin e Kosovës nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Unë edhe në KPF kam kërkuar që ta dimë a është pronë private, shtetërore ose mos është pronë e agjensionit të pyjeve, jam duke e ditë që nuk jemi duke e shpallur si interes i përgjithshëm por jemi duke zgjerimin e zonës ndërtimore. Drejtori ka deklaruar se do të bisedoj me organet përgjegjëse mos ka ndonjë pengës, dua ta di a ka biseduar drejtori, ose ne sot duhet të marrim një vendim që të del në diskutim publikë për tu iniciuar procedurat e mëtutjeshme.

Fehmi Hoxha – PO gjithsesi jam konsultuar me MMPH, kjo sot që jemi duke e bërë është iniciimi i procedurave për zgjerimin e zonave ndërtimore. Ne nuk jemi duke e shpallur si interes i përgjithshëm, këto janë 6 parcela ngastra kadastrale, janë pronë komunale që menaxhohen nga agjensioni i pyjeve. Ne nuk bëmë ndesh me ligjin absolutisht, kur e përcaktojmë këtë zonë pas miratimit tuaj të gjitha këto parcela edhe nëse nuk i rikthehen komunave në menaxhim atëherë do i menaxhoj agjensioni i pyjeve mirëpo ai do ta ketë destinimin e caktuar dhe qytetarit ja përcakton për qatë destinim.

Kryesuesi – E qes në votim pikën e 4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për zgjerimin e zonës ndërtimore në Rahovec: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 4 e rendit të ditës. Pika radhës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

Kujtim Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, është kërkesë e bashkësisë islame për ndarjen enjë prone me një sipërfaqe prej 300 m² e cila gjendet në parcelën 5570 e gjitha është pronë komunale që shfrytëzohet për varreza myslimane. Bashkësia islame kërkon që ti ndahet kjo parcelë për ndërtimin e një kapelle që do të shërbej për pastrimin e kufomave. Parcela është me sipërfaqe 2 hektar e 22 ari por nga kjo parcelë kërkohet të ndahen vetëm 3 ari për ngritjen e kësaj kapelle.

Kadri Dellova – Terminologjia kapell nuk është e duhur, mendoj se mos është ma mirë të jetë morg për pastrimin e të vdekurve mysliman.

Luljeta Kadiri – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në këtë rast fjalën kapell do ta kisha zëvendësuar me fjalën morg, por këtu nuk ka vend as fjala morg sepse nëse emëron një objekt me fjalën morg pastaj duhet me ja siguri edhe kushtet optimale, temperaturë për me e mbajte kufomën në kushte standarde deri në vendim për varrosje, mendoj se këtu mundemi me e përdor vetëm terminologjinë vend shfrytëzim për rite fetare.

Selim Duraku – Praktika të ngjashme kemi edhe në xhamitë e tjera të cilët e shfrytëzojnë vendin për pastrimin të cilët e kanë një objekte 5 me 5, këtu është duke u folur për 3 ari, nëse bëhet fjalë për një morg që do të ketë

friza dhe sendet e tjera që i nevojitet një morgu isha pajtuar, por nëse është vetëm për një objekt për pastrim të kufomave mendoj se 3 ari tokë është shumë.

Kryesuesi – Qëllimi i kësaj kërkesë është të ketë vend ku të pastrohen kufomat dhe ku të rruhen kufomat, projekt nuk kanë, por nëse doni ju mundeni të kërkonit edhe projektin.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, personalisht e mbështes këtë iniciativë sepse është mirë të kemi një vend ku do të pastrohen dhe ku do të rruhen kufomat deri sa të varrosen. Këtu pati disa gabime teknike rreth formulimit a të jetë morg apo kapell, mendoj se ma mirë kishte me qenë të jetë objekt për ruajtjen dhe pastrimin e kufomave. Pastaj tek pika e dytë shkruan varrezat myslimane, Varrezat duhet të shkruan me shkronja të madha. Propozoj që në pikën e dytë të hiqet fjalimi ndërtimi i kapellës për pastrimin e të vdekurve, kufomave në Rahovec, mendoj se është e pa nevojshme.

Florije Boshnjaku – Ne këtë vendim ja kemi miratuar një herë kur ja kemi dhënë në shfrytëzim tokën në qendër, mirëpo aty nuk është lejuar. Duhet të kemi të qartë se çka jemi duke dhënë sepse në propozim thuhet vetëm për pastrimin e kufomave. Pastaj këtu thuhet që të jepet me afat afatgjatë, pyes drejtorin për sa vite propozojnë ata që ne të ja japim në shfrytëzim këtë parcelë. Tek neni 3 në kllapa shkruan pastrimi i kufomave, drejtor nuk lejohet të shkruhet në kllapa me aktet administrative, ne duhet të kemi të qartë se çka jemi duke votuar, mendoj se secili prej neve jemi për por së pari duhet të dimë se çka votojmë. Ta kishim pas kërkesën më të çartë ose ndonjë projekt kishte me qenë shumë më mirë, përndryshe ne jemi për.

Kryesuesi - BI e Rahovecit këtë parcelë e ka lypë në shfrytëzim të përhershëm dhe në kërkesë e kanë cek vetëm për pastrimin e kufomave. Pastaj Kryesuesi e lexon kuvendarëve kërkesën e BI të Rahovecit.

Xhihad Vuçitërna – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, me dijeninë time mendoj se kërkesa bëhet me qëllim që kufomat mos të pastrohen nëpër oborre, mendoj që fillimisht objekti do të shfrytëzohet për pastrimin e kufomave por qëllimi final është që kufomat të cilët duhet të presin një kohë deri sa të pastrohen munden të qëndrojnë në atë kapell ose morg. Pastaj kur do që do të paraqiten kushtet ai objekt do të pajiset me frigorifer dhe pajisjet e tjera përcjellëse. Me rëndësi është që e gjitha kjo kërkesë dhe ky diskutim bëhet me qëllim që neve të na lehtësohet atëherë kur jemi në kohërat më të vështira, ne si kuvend kemi pas raste kur kemi marrë vendim për ti ndihmuar BI me heqje të shpenzimeve, kjo është në vazhdimësi dhe mbi të gjitha kjo bëhet në interes tonin si qytetar, pastaj BI nuk ka ndonjë organ tjetër që ti drejtohet përveç Kuvendi të Komunës. Kërkoj nga ju që ta përkrahni këtë kërkesë për shkak se nuk ka ndonjë qëllim tjetër përveç qëllimit human.

Nazim Veliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, mendimi imë është i njëjtë si i Xhihadit sa i përket kësaj kërkesë të BI, më shqetëson fakti që disa koleg diskutuan si koça shumë sa i përket emërimit, ne duhet të dimë se klerikët fetar nuk janë juristë por janë klerik të fesë islame, pastaj ata nuk kanë kërkuar nga ne se si të emërohet ky objekt por kanë kërkuar vetëm 3 ari tok, për mua është pak 3 ari të isha pyetur vetëm unë ju kisha ndarë 10 ari sepse ata janë duke e kërkuar për shërbim të popullit. Sa i përket asaj se a do të ketë frigorifer, mundet të ketë nëse edhe ne investojmë si kuvendarë. Sa i përket se për sa kohë me ja dhënë tokën në shfrytëzim BI unë ja kisha dhënë deri sa të ekzistoj njerëzimi sepse ajo do na shërbej neve. Këtë është mirë të ketë çdo fshat i komunës së Rahovecit e jo të lahen kufomat nëpër oborret e shtëpive tona.

Florije Boshnjaku – Vendimi që është këtu para neve thuhet afatgjatë, ligji e thotë se mundesh me e dhënë pronën deri në 99 vite me të drejtë vazhdimi ma shumë nuk mundesh, ne sot duhet të përcaktohem se sa duhet të ja japim, pra në vendim të ceket për 99 vite.

Fatmir Iska – Pajtohem me këtë vendim dhe sigurisht se do ta përkrah. Shumë mirë në tre nenet e para ceket kapell për pastrimin e të vdekurve, por nuk ceket edhe mbajtja e kufomave deri sa të bëhet varrimi i tyre. Mendoj se kjo sipërfaqe është e mjaftueshme gjithashtu edhe uji dhe rryma do të shtohen në atë pjesë. Në mandatin e kaluar Kuvendi Komunal e ka ndarë një pjesë për ndërtimin e atij objekti që është në qendër të Rahovecit, aty është paraparë edhe larja e kufomave, meqenëse ajo punë nuk është mirë të bëhet në atë pjesë sepse aty kah edhe banorë të tjerë që jetojnë aty edhe unë të kisha qenë aty nuk do kisha lejuar me forcat e mija që i kam. Është mirë që tani e kemi këtë parcelë për pastrimin e kufomave, ne e kemi marrë një vendim për kryerjen e shërbimeve të varrimit nga BI, por mendoj se ne nuk kemi të drejtë të i kushtëzojmë qytetarët se ku duhet të i pastrojnë kufomën e të afërmit të tyre.

Kryesuesi – E qes në votim propozim vendimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me vendim afatgjatë prej 99 viteve: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar propozim vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vite. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për subvencionimin e festivalit Hardh – Fest në Rahovec.

Lulzim Sylejmani – Para jush keni një propozim vendim për mbështetjen e shoqatës Hardh – Fest, për festën e vjeljes së rrushit 2016, me rishikimin e buxhetit ju e dini se një pjesë e komunalive dhe një pjesë të mallrave dhe Shërbimeve i kemi bartë me vlerë prej 8,000.00 € në Drejtorin e bujqësisë, konkretisht në kategorinë e subvencioneve, pra ka qenë e vetmja mundësi për me mbështet Hardh Festin. Shoqata e ka pasqyruar një shpenzim në propozim vendim por mjetet për subvencionim në disponim janë vetëm 8,000.00 €. Kërkoj nga ky kuvend që këtë propozim vendim ta aprovojnë në mënyrë unanime sepse kjo festë vite për vite është duke shkuar duke u madhështuar. Nga shoqata Hardh Festë kërkohet që mbasi të kryhet festa të na sjellë në Komunë raportin mbi shpenzimet.

Florije Boshnjaku – Nuk jam duke e ditë se si ka mundur të vije në Kuvend kështu ky propozim vendim, arsyeja është kjo? Thotë: Miratohet propozimi i Kryetarit me nr. pr. kaq kaq shoqatës Hardh Festë të i ndahet dhe të i ndihmohet me shumën prej 8.000 €, ne të gjithë jemi pro këtij propozimi. Me vonë në specifikacion në vendim bëhet ndamës. Ata kanë kërkuar 9,830.00 € sipas specifikacionit, komuna ka mundësi të i ndajë 8.000 €, komuna duhet të del me propozim prej 8.000 €, sepse propozimi me vendim është në kundërshtim, specifikacioni nuk guxon me figurë në vendim në vendim duhet të jetë vetëm aq sa i ndanë komuna e jo në fillim thotë komuna i ndanë 8.000 € kurse në të njëjtin vendim më poshtë në specifikacion është shuma 9,830.00€. pra specifikacioni duhet të jetë deri në 8.000 € aq sa ka ndarë komuna.

Kryesuesi - E qe në votim pikën e 6 të Propozim Vendimit për subvencionimin e festivalit Hardh – Fest në Rahovec me shumën prej 8.000 €, me vërejtjet që u dhanë, pra specifikacioni duhet të hiqet nga vendimi: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 6 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës.

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit Vendimit për zëvendësimin e një anëtarë të ri të komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale me anëtar të ri.

Propozimi është që në vend të ish drejtorit të bujqësisë Lulzim Haska të jetë drejtori aktual i bujqësisë Fehim Fetoshi. E qes në aprovim këtë propozim: Konstatohet se në mënyrë unanime ka kaluar pika e 7 e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit të punës të Kuvendit për vitin 2017.

Në këtë punëtori duhet të marrin pjesë përpos këtij grupi që do ta formojmë sot edhe drejtorët drejtorive komunale, sipas përfaqësuesit të Demosit kjo punëtori do të mbahet në Përvalle. Unë jam pak i zhgënjyer me ekzekutivin për planin e punës që e kemi pas për këtë vite, në bordin e drejtorëve të gjithë drejtorëve ju kam dhanë planin punës por shumica nuk ju kanë përmbajtur, sepse në muajt e caktuar nuk janë duke ardhur pikat në Kuvend që janë paraparë nga drejtorët e drejtorive. Sugjerimi im është që kur ta bëjmë aprovimin e planit të punës për vitin 2017 të i japim një vërejtje drejtorëve që për vitin 2017 të kenë parasysh caktimin e pikave të rendit të ditës. Grupi punues do të përfshi të gjitha subjektet që janë në Kuvend.

Rasim Fazliu – Nga PDK-ja propozojmë Rasim Fazliun dhe Xhafer Bytyqin.

Fatmir Iska – Nga AAK-ja propozojmë Fatmir Isken dhe Afrim Limanin.

Selim Duraku – Nga LDK-ja propozojmë Selim Durakun dhe Hysni Gashin.

Kryesuesi – Propozohen këta anëtarë: Nga Vetëvendosja Azbi Gashi. Nga PD-ja Xhihad Vuçitërna dhe nga LB-ja Bahtjar Hoti. Kush është për këto propozime të anëtarëve për këtë grup punues. Konstatohet se në mënyrë unanime janë aprovuar propozimet e dhëna. Ju falënderoj për pjesëmarrje në mbledhje shihemi në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 12:40

**Procesmbajtësi,
Skender Hamza**

**K R Y E S U E S I,
Nahit Elshani**